

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Shukri Sylejmani dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses S. S., nga Prishtina, të cilën e përfaqëson N. H., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës NLB Prishtina, për shkak të kompensimit të të ardhurave personale, përkitazi me revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr.4408/2014 datë 3.6.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 4.10.2016, merr këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr.4408/2014 datë 3.6.2016.

Aktgjykimi i cituar ndryshohet vetëm përkitazi me kamatën ashtu që detyrohet e paditura që paditëses shumë e aprovuar t'ia paguajë me kamatë në lartësi të depozitimeve kursimore të pa afatizuara të cilat i paguajnë bankat afariste në Kosovë, pa destinim të caktuar mbi 1 (një) vit, duke filluar nga data 28.4.2014 ( dita e ekspertizës) e deri në pagesën definitive.

### A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr.4408/2014 datë 3.6.2016, janë refuzuar si të pabazuara ankesa e paditëses dhe ankesa e të paditurës, ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore, Prishtinë, C.nr. 2939/2013 datë 30.6.2014, me të cilin me pjesën I të dispozitivit është aprovuar kërkesëpadia e paditëses. Me pjesën II të dispozitivit është detyruar e paditura që paditëses për shkak të largimit jo ligjor nga puna, në emër të pagave të porealizuara për periudhën kohore nga data 1.4.2006 deri më 31.12.2013 t'ia

kompensoj shumën neto të parave në vlerë prej 29.838,86 €, në emër të kontributit pensional paditëses, në trustin pensional t'ia kompensoj shumën e parave prej 1.363,38 €, ndërsa në emër të tatimit në paga shumën prej 1.374,38 €, bashkë me kumatën në shumën prej 1.374,38 €, të gjitha këto në afatin kohor prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Me pjesën III të dispozitivit është detyruar e paditura NLB Prishtina që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës në shumën e parave prej 420 €.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë e paditura me kohë ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe për shkak të tejkalimit të kërkesëpadisë, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të prishen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi aktgjykimin e goditur konform dispozitës së nenit 215 të LPK dhe gjeti se:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut Prishtinë, Ac.nr. 382/2010 datë 13.11.2012, është refuzuar ankesa e të paditurës si e pabazuar dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Komonale Prishtinë, C.nr. 188/2007 datë 9.10.2009, me të cilin është aprovuar kërkesëpadija e paditëses, është anuluar si i kundërligjshëm vendimi i Bordit Drejtues të paditurës datë 30.12.2004 dhe është obliguar e paditura që paditësen ta kthejë në punë bashkëpunëtore profesionale në Shërbimin e kreditimit në filialin e të paditurës, me të gjitha të drejtat nga puna. Në procedurën sipas revizionit të paraqitur nga e paditura, Gjykata Supreme e Kosovës, ka refuzuar revizionin në pjesën e aktgjykimit të gjykatave të instancës më të ulët me të cilën vendimi i Bordit Drejtues shpallet si i kundërligjshëm, ndërsa ka kthyer në rigjykim pjesën e aktgjykimit ku paditëses i njihen të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës.

Në rigjykim lidhur me pjesën e aktgjykimit ku paditëses i njihen të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës, pas precizimit të kërkesëpadisë për kompensimin e pagave, gjykata e

shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar, dhe ka obliguar të paditurën më afër përshkruar si në dispozitivin e aktgjykimit C.nr.2939/2013 datë 30.6.2014.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën sipas ankesës ka gjetur se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejt, i bazuar në ligj dhe shkresat e lëndës, si dhe janë dhënë arsye të mjaftueshme në aktgjykimin e ankimuar, pastaj ka refuzuar ankesën si të pabazuar dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykatat e instancës më të ulët drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar. Në aktgjykimet e tyre ato kanë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë e revizionit.

Të pabazuara janë thëniet e revizionit se gjykata e shkallës së dytë nuk ka arsyetuar pretendimet nga ankesa e të paditurës, ngase sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, gjykata e shkallës së dytë në aktgjykimin e saj ka dhënë arsye të mjaftueshme për një gjykim të drejtë e të bazuar në ligj.

Pretendimi i të paditurës i cekur në revizion se gjykata e shkallës së dytë ka tejkalluar kërkesëpadinë e paditëses, paraparë sipas nenit 214 par. 1 pika (c), (Ligji nr. 04/L-118 Për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore, pika d), Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se neni i cekur ka të bëjë me shkaqet e paraqitjes së revizionit, ndërsa faktin e cekur se tejkalimi i kërkesëpadiës ka të bëjë me atë se paditëses i është caktuar paga e plotë për kohën kur e njëjta aktivisht nuk ka punuar, Gjykata Supreme e Kosovës, e vlerësoi si të pabazuar, ngase me aktgjykimet e cekura më lartë është vërtetuar se vendimi i të paditurës për mos vazhdimin e kontratës së punës është i kundërligjshëm, që si pasojë ka pas paditësja mos t'i realizon të drejtat e saj për pagat, kontributin pensional dhe trustin pensional.

Faktin e cekur se e paditura e ka përmbushur obligimin ligjor, sepse paditëses ia ka paguar pagat sipas kërkesës së datës 25.1.2006, Gjykata Supreme e Kosovës, e shqyrtoi, por kjo Gjykatë shton se paditësja sipas kërkesëpadiës së precizuar pagat i ka kërkuar për periudhën kohore nga data 1.4.2006 e deri më 31.12.2013, andaj një pretendim i tillë i të

paditurës se çështja juridike për kompensimin e pagës është res-judicata, e vlerësoi si të pabazuar.

Gjykatat e instancës më të ulët sipas vlerësimit të kësaj Gjykate në mënyrë të drejt ka zbatuar dispozitat ligjore të nenit 14 të Rregullores nr. 2001/27 Për Ligjin Themelore të Punës në Kosovë, i cili nen rregullon çështjen e pagës, ndërsa në revizion nuk është cekur asnjë pretendim konkret se cili nen i ligjit material është zbatuar në mënyrë të gabuar. Neni i cekur në revizion 294 par. 1 të LPP, ka të bëjë me detyrimin e debitorit për durim dhe mos veprim ndërsa në rastin konkret në këtë fazë të procedurës nuk kemi të bëjmë me procedurën përmbartimore.

Lidhur me caktimin e kamatës aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët janë marrë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, andaj si pasojë patën ndryshimin e saj, ashtu që paditëses borxhi duhet t'i paguhet me kamatë në lartësi të depozitimeve kursimore të paafatizuara të cilat paguajnë bankat afariste në Kosovë pa destinim të caktuar mbi 1 (një) vit nga data 28.4.2014 e deri në pagesën definitive.

Nga sa u tha më lartë e me zbatimin e nenit 222 dhe 224 par. 2 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.280/2016, më 4.10.2016

Kryetare e kolegjit,

Emine Kaçiku